



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.15 prot.

Himarë, më 31.10. 2025

ZBARDHJE E PROTOKOLLIT NGA ORGJINALI I MBLEDHJES TË RADHES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË.

Sot më datë 31.10.2025 zhvillohet mbledhja e radhës kërkuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak. Hapet mbledhja në orën 10:30.

Të ftuar kryetari Bashkisë, nënkryetarët e Bashkisë, drejtoritë, administratorët e njësive, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët :

Dhimitër Kapaj, Lenica Kocani, Elisabeta Lamaj, Aleks Llazari , Mirka Gjiçali, Timoleo Gërdhuqi, Gjergji Iliadhi, Milto Nika, Afrovita Dhimojani, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Miltiadh Prifti, Maks Vlashi, Qirjako Mërkuri, Artan Bala, Theodhori Foto, Loreta Isufi, Nikolin Laska, Silva Burbo.

Plotësohet kuorumi me 19 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Hap mbledhjen kryetari i këshillit.

Fillon rendi i ditës sipas njoftimit.

Këshilltarët bien dakord që pika e parë e rendit të ditës të kalojë për shqyrtim në fund të mbledhjes.

Pika e dytë: Për titujt e nderit dhe emërtimet e rrugëve.

Sqaron Drejtoria Juridike për këtë projektvendim.

Këshilltarja Kokaveshi kërkon që të ketë disa ndryshime për emërtimet e shesheve dhe duke u bërë dëgjesa publike për këto emërtime.

Sqaron Kryetari i Këshillit Bashkiak për këtë projektvendim, për shtim emrash ose anëtarësh, për përzgjedhjen e tyre.

Sqaron këshilltarja Dhimojani për komisionin e titujve dhe ndereve dhe propozon të ngrihet një komision tjetër për emërtimin e rrugëve dhe shesheve.

Këshilltari Gërdhuqi sqaron për këtë projektvendim përse i përket këtij komisioni, se për miratimin e titujve dhe emrave të shesheve do të vijne në këshill për miratim, kështu që nuk është e nevojshme ngritja e një komisioni tjetër. Propozon që, administratorët e njësive administrative të bëhen pjesë e propozimeve për emrat e shesheve dhe titujve të nderit.

Kalon për votim ky projektvendim: 16 vota pro, 3 kundër, 0

Pika e tretë: Për projektvendimin e VKM nr.329.

Sqaron Drejtoria Juridike për këtë projektvendim.

Falenderohet Drejtoria Juridike për të dyja projektvendimet, si për rregulloren e titujve të nderit ashtu edhe për projektvendimin e dytë, që është VKM nr.329.

Këshilltarja Dhimojani i bën vërejtje Kryetarit të Këshillit Bashkiak për etikën e këshilltarëve dhe rregulloren e Këshillit Bashkiak.

Këshilltari Gërdhuqi propozon për tarifën e zonës A dhe B, mundësinë e uljes së tarifës.

Këshilltarja Burbo pyet Drejtorinë Juridike se si do të vepohet në rastet kur këto prona janë me mbivendosje të natyrave të ndryshme. Sqarohet nga drejtoria përkatëse.

Këshilli vendos që tarifa fillestare e aplikimit për regjistrim të behet nga 10.000 (dhjetë mijë) lekë të reja në 5.000 (pesë mijë) lekë të reja.

Kalon për votim ky projektvendim:

14 vota pro, 4 kundër, 0 abstenim.

Pika e katërt: Për Shoqatën Sportive “Klubi Himara”.

Sqaron përsëri Drejtoria Juridike për këtë projektvendim.

Ky është akt-themelimi dhe ky projektvendim duhet vetëm për regjistrimin në Gjykatë.

Këshilltari Gërdhuqi pyet nëse kjo shoqatë që do të krijohet do të marrë asetet e Bashkisë në pronësi të saj dhe propozon dëgjese publike për këtë projektvendim.

Në vijim, Kryetari i Këshillit Bashkiak propozon dëgjese publike për këtë projektvendim dhe pjesë e bordit të jetë edhe një sportist me emër nga territori i Bashkisë Himarë.

Sqaron Këshilltari i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë që akt-themelimi duhet vetëm për t’u regjistruar në Gjykatë dhe që pas regjistrimit mund t’i shtojmë ose heqim emra nga bordi drejtues.

Këshilltarja Dhimojani propozon 3 pika:

1. Të ketë një grup anëtarësh nga Shoqeria Civile, ish-Sportistë dhe qytetarë me vlera sportive në qytetin e Himarës.
2. Financimi

3. Transparenca

Këshilltarja Gjicali propozon disa emra për anëtarë bordi, që janë qytetarë të Bashkisë Himarë dhe ish-Sportistë.

Ky projektvendim shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pika e pestë: Ndihma ekonomike 6%.

Kalon për votim: 16 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika e gjashtë: Për vend-depozitim të mbetjeve të ngurta në zonën e Vishës.

Sqaron këtë relacion Drejtoria e Urbanistikës sipas teknikave specifike dhe kondicioneve urbanistike.

Këshilltari Gërdhuqi pyet nëse në këtë venddepozitim ka mundësi të një makinerie grirëse për inertet e ngurta.

Këshilltari Gërdhuqi propozon, që sipas kërkesës së disa banorëve, të shihet mundësia e spostimit të kësaj pike transferimi për mbetjet e ngurta.

Kalon për votim ky projektvendim: 7 vota pro, 6 kundër, 2 abstenim.

Pika e parë: Për “Dulla Konstruksion Sh.p.k”

Këshilltarja Kocani ka shumë dyshime për këtë projektvendim. Insiston se dëgjesa publike është bërë me banorë që nuk kanë lidhje me atë zonë dhe që hektarët që kërkohen për atë aktivitet janë shumë.

Kalon për votim: 2 vota pro, 2 abstenim, 6 kundër.

Ky projektvendim nuk kalon.

Pika e shtatë: Po shqyrtohen kërkesa të ndryshme nga qytetarë të Bashkisë Himarë dhe me vendim Këshilli ato i kalojnë drejtorive përkatëse për zgjidhje.

Mbyllet mbledhja.

Sekretari : Zaho Dedi